



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice

Buletini informativ

- * Aktivitetet e përgjithshme
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- * Aktivitetet nga trajnimet për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor të gjykatave dhe prokurorive
- * Aktivitetet për trajnues
- * Aktivitetet për profesionet e lira

Shtator 2023

Aktivitetet e përgjithshme

Donacion - laptop nga UNDP për Akademinë Drejtësisë



Më 11 shtator 2023, në Akademinë e Drejtësisë u zhvillua Ceremonia e pranim-dorëzimit të 10 laptopëve ndërmjet perfaqësuesëve të UNDP-së dhe Akademisë së Drejtësisë.

z. Enver Fejzullahu-Drejtor Ekzekutiv i

Akademisë së Drejtësisë falënderoi UNDP-në për mbështetjen e vazhdueshme për Akademinë në realizimin e aktiviteteve të saj.

znj. Yuliya Scherbinina -zëvendëse shefe e misionit të UNDP-së në Kosovë, nga ana tjetër u shpreh e lumtur për bashkëpunimin me Akademinë dhe theksoi se bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve do të vazhdoj për të koontribuar në zhvillimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë.

Në këtë ceremoni morën pjesë zyrtarë nga UNDP, trajnues dhe staf nga Akademia.



Takimi me Organizatat Joqeveritare/Shoqërinë civile



Me 29 shtator 2023, në vazhden e aktiviteteve për vlerësimin e nevojave trajnuese dhe hartimit të Programit trajnues për vitin 2024 është realizuar takimi me Organizatat jo qeveritare që punojnë dhe kontribuojnë në fushën e Sundimit të Ligjit.

Qëllimi i këtij takimi ishte njoftimi i Organizatave Joqeveritare me proceset e punës së Akademisë së Drejtësisë me theks procesin aktual të vlerësimit të nevojave trajnuese të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe kontributi

potencial i tyre për Programin trajnues të vitit 2024.

Me rastin e këtij takimi ata u njoftuan me prioritetet e AD-së për Programin trajnues, veçanërisht kërkesat nga dokumentet strategjike dhe nevoja për mbështetje për disa nga aktivitetet përkatëse.

Organizatave shoqërisë civile pjesëmarrëse në këtë takim ofruan gatishmërinë e tyre për mbështetjen në trajnimet që potencialisht do të jenë në program për luftimin e terrorizmit, ekstremizmit të djathtë, për mbrojtjen e të drejtave të njeriut etj.

Pjesëmarrës në këtë takim ishin; CEL Kosova, CSGD, Terre Des Hommes. Lëvizja Fol, BIRN dhe EUCOJUST.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar

Trajnimi fillestar për prokurorët e sapo emëruar, (gjenerata e X)- 2023-2024



Për 21 prokurorët e kësaj gjenerate gjatë muajit shtator janë realizuar gjithsej 15 sesione të trajnimit teorik dhe 12 ditë të trajnimit praktik.

Disa sesione të trajnimit teorik ishin vazhdim i sesioneve nga moduli: Kodi Penal i Republikës së Kosovës, moduli: Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe Shkathësitë personale dhe ndër personale. Ndërkaq është filluar dhe janë realizuar edhe sesione trajnuese nga moduli Kodi i Procedurës Penale.

Nga moduli Kodi Penal i Republikës së Kosovës është realizuar 1 sesion trajnues me theks te veprat penale kundër martesës dhe familjes, veprat penale kundër shëndetit publik dhe veprat penale të narkotikëve.

Në kuadër të modulit: Kodi i Procedurës Penale është realizuar 1 sesion trajnues nga nën moduli “Fillimi i hetimeve formale dhe procedura penale” me ç’rast është shtjelluar: Procedura paraprake dhe fillimi i hetimeve.

Në vijim të këtij moduli është realizuar 1 sesion trajnues nga nën moduli: “Kallëzimi penal” me ç’rast është trajtuar procedura e fillimit të kallëzimit penal.

Nga nën moduli: “Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë” janë realizuar 2 sesione trajnuese prej të cilëve janë shtjelluar: ndalimi i të pandehurit për t’iu afruar vendit të caktuar dhe personave të caktuar, thirrja, Urdhërarrestit dhe Premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin.

Në kuadër të Modulit: Shkathësitë personale dhe ndërdisiplinare, janë realizuar 7 sesione në të cilat janë diskutuar: Integriteti, Kodi i Etikës profesionale për prokurorë, llogaridhënia dhe transparenca, masat disiplinore, parimet bazë të etikës profesionale, procedura disiplinore ndaj prokurorëve, procedura disiplinore për prokurorët.

Në kuadër të Modulit: Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar janë realizuar 2 sesione nga nën moduli: “Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar” me ç’rast janë trajtuar: bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje civile dhe bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështje penale.

Ndërkaq në kuadër të modulit: Legjislacioni dhe shkathësitë plotësuese, është realizuar 1 sesion trajnues nga nën moduli: “Kodi i drejtësisë për të mitur”, në të cilën janë trajtuar Dispozitat e përgjithshme që e karakterizojnë procedurën penale ndaj të miturit.

Gjatë sesioneve të trajnimit teorik prokurorët patën mundësinë e studimit të rasteve nga praktika gjyqësore të cilat njëherësh janë diskutuar, analizuar për të identifikuar praktikat më të mira në situatat përkatëse.

Trajnimi fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar, (gjenerata e X)-2023 -2024



Gjatë muajit shtator për 28 gjyqtarët e sapo emëruar janë realizuar gjithsej 40 sesione të trajnimit teorik ndërkaq për një gjyqtarë 24 ditë të trajnimit praktik në gjykatë nga lëmia civile. Trajnimi praktik për gjyqtarin përkatës është filluar më herët meqë ka përfunduar sesionet e trajnimit teorik nga lëmia civile ndërkaq në lëmine penale me grupin e prokurorëve në trajnimin fillestar, meqenëse fillimisht ka qenë i emëruar si prokuror.

Sesionet e trajnimit teorik ishin nga nën modulet e modulit: Kodi Penal i Republikës së Kosovës dhe nën modulet e modulit: Kodi i Procedurës Penale.

Nga moduli: “Kodi Penal i Republikës së Kosovës, përkatësisht nën moduli për pjesën e përgjithshme janë realizuar 8 sesione trajnuese me theks te dënimet plotësuese, dhuna dhe kanosja, lajthimi, nocioni dhe elementet e veprës penale, pakujdesia, parashkrimi, pasojat juridike dhe rehabilitimi i të dënuarave, si dhe për sanksionet penale – dënimet kryesore.

Në vijim të këtij moduli për pjesën e veçantë janë realizuar 9 sesione trajnuese. Në këto sesione janë trajtuar është ligjore nga Kapitulli XXVIII, Veprat Penale Kundër Sigurisë së Përgjithshme të Njerëzve dhe Pasurisë, Kapitulli XXX, Veprat Penale Kundër Sigurisë së

Trafikut Publik, dhe kapitulli XXXI, Veprat Penale Kundër Administrimit të Drejtësisë dhe Administratës, Korrupsioni, Ndërtimi pa leje, Veprat penale kundër jetës dhe trupit, Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut, Veprat penale kundër martesës dhe familjes, veprat penale kundër shëndetit publik dhe veprat penale të narkotikëve, Veprat penale kundër të drejtave në marrëdhëniet e punës dhe veprat penale kundër integritetit seksual, Veprat penale nga kapitulli 401 i KPRK-së.

Nga nën moduli: “Krimi kibernetik” janë realizuar 3 sesione nga i cili janë trajtuar: Pajisjet Dixhitale, provat Elektronike dhe teknologjia.

Nga nën moduli: Përgjegjësia e personave juridik janë realizuar 2 sesione me ç’rast janë diskutuar bazat dhe kufiri i përgjegjësisë së personave juridik, përgjegjësia penale e personave juridikë dhe kuptimi i personit juridik. Me 1 sesion trajnues për Shpenzimet e Procedurës penale përmbillen sesionet trajnuese për muajin shtator nga moduli Kodi Penal i Republikës së Kosovës.

Nga moduli Kodi i Procedurës Penale janë realizuar 2 sesione trajnuese për dëshmitarët dhe të dëmtuarit.

Në vijim të këtij moduli janë realizuar edhe 3 sesione trajnuese për “Masat e fshehta të hetimit dhe të vëzhgimit” me theks te procedura penale lidhur me këto masa.

Nga nën moduli: “Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë” është realizuar 1 sesion nga i cili është shtjelluar: thirrja, Urdhër arresti dhe Premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin.

Nga nën moduli: “Parimet, kompetencat dhe përjashtimi i gjyqtarit nga procedura penale” janë realizuar 2 sesione trajnuese me ç’rast janë trajtuar aspektet e rëndësishme të kësaj procedure.

Në kuadër të nën modulit: “Procedura paraprake” janë realizuar 2 sesione të cilat kanë qenë të përqendruara në shpjegimet e nevojshme sa i përket specifikave të kësaj procedure dhe hapat konkret që duhet ndërmarrë gjyqtari i procedurës paraprake.

Dhe nga nën moduli: “Roli i gjyqtarit në procedurën parapenale” janë realizuar 5 sesione në kuadër të cilave janë trajtuar çështje ligjore specifike si konfiskimi sipas kompetencave të zgjeruara, kontrollimi i personit sendit dhe objekteve, roli i gjyqtarit në procedurën parapenale, roli i gjyqtarit në procedurën paraprake në caktimin dhe vazhdimin e masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurën penale dhe sekuestrimi i përkohshëm. Dhe në kuadër të nën modulit: “Dëshmitarët dhe të dëmtuarit” anë realizuar **2 sesione** nga ku janë trajtuar: të dëmtuarit në kuptimin e përgjithshëm, të kuptuarit e dëshmitarit bashkëpunues.

Gjatë sesioneve të trajnimit teorik gjyqtarët patën mundësinë e studimit të rasteve nga praktika gjyqësore të cilat njëherësh janë diskutuar, analizuar për të identifikuar praktikat më të mira në situatat përkatëse.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Trajnim: Akuzimi dhe dënimi i rasteve të dhunës në familje

Më 05 shtator 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme dhe në bashkëpunim me Bashkimin Evropian – EUKOJUST është realizuar trajnimi me temë “Akuzimi dhe dënimi i rasteve të dhunës në familje”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive për trajtimin e rasteve të dhunës në familje në pajtim me kornizën ligjore dhe standardet ndërkombëtare, përkatësisht Konventën e Stambollit dhe zgjidhjen meritorë të rasteve përkatëse.

Ashtu siç ishte paraparë, trajnimi ofroi mundësinë e diskutimit të rasteve të dhunës në familje dhe nevojën për akuzimin dhe dënimin në proporcion me peshën e krimit dhe në përputhje me standardet ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Trajnimi në fillim u përqendrua në kornizën ligjore vendore dhe ndërkombëtare për trajtimin e rasteve të dhunës në familje duke përfshirë edhe Udhëzuesit e Gjykatës Supreme të Kosovës si Udhëzimi lidhur me cilësimin juridik dhe trajtimin e rasteve të Dhunës në

Familje dhe Udhëzuesi për politikën ndëshkimore. Vëmendje e veçantë i është kushtuar bashkëpunimit ndërinstitucional që duhet të kenë gjyqtarët dhe prokurorët duke përfshirë edhe akteret tjerë relevantë në mënyrë që këto raste të trajtohen në mënyrë meritorë.

Në pjesën e dytë është diskutuar për vlerësimin e seriozitetit të rasteve të dhunës në familje nga gjyqtarët dhe prokurorët duke marrë parasysh natyrën specifike, vonesat e panevojshme, masat paraprake, përfaqësimi i prokurorisë në aktakuzat e dhunës në familje, kompensimi i dëmit, shqyrtimi i dosjeve të mëparshme të prokurorisë lidhur me kryesit dhe aspekte tjera të rëndësishme gjatë trajtimit të këtyre rasteve. Fokusi i veçantë gjatë këtij trajnimi ishte edhe vështrimi i përgjithshëm i faktorëve lehtësues dhe rëndues në dënimin e rasteve të dhunës në familje dhe aktgjykimet e gjykatave në procedurë penale duke përfshirë edhe vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së.

Këtë trajnim e vijuan 21 gjyqtarë dhe 10 prokurorë kryesisht të nivelit themelor dhe nga të gjitha regjionet e Kosovës.



Trajnim: Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror dhe në rastet e ndryshimit të statusit të tyre



Më 05-06 shtator 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë: “Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror dhe në rastet e ndryshimit të statusit të tyre”

Trajnimi ofroi mundësinë e diskutimit rreth mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror, si dhe për format e mbrojtjes së veçantë të këtyre fëmijëve të cilat janë të normuara me Ligjin për Familjen (LFK), duke pasur si referencë Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Vëmendje e veçantë i ‘u kushtua adoptimit, amësisë, mënyrave dhe metodave të komunikimit të gjykatës me fëmijët në procedurë gjyqësore dhe mbrojtjes së të drejtave të tyre si dhe risive dhe zbatimit në praktikë të dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.

Në cilësi të trajnuesve ishin Kryetari i Gjykatës së Apelit z. Valon Totaj dhe gjyqtari i Gjykatës së Apelit z. Lumni Sallauka, të cilët ofruan konceptet themelore të Ligjit për Familjen duke i zbërthyer dhe ilustruar me raste hipotetike. Gjithashtu trajnuesit parashtruan pyetje për pjesëmarrësit të cilët më pas ndanë përvojat e tyre në lidhje me situata të caktuara. Metodologjia u vlerësua efikase pasi pothuajse të gjithë pjesëmarrësit ishin të angazhuar në diskutime. Rrjedhimisht, disa konkluzione dhe rekomandime të përgjithshme u nxorën nga ky trajnim dhe janë si në vijim:

Gjykata t’i kujtoj fëmijëve se ata nuk merren në pyetje për shkak se kanë bërë ndonjë vepër por sepse gjyqtari ka nevojë për ndihmën dhe informacionin e tyre për të marrë vendime sa më të drejta;

Gjykata të përdorë pyetje të hapura sepse fëmijëve ju japin mundësinë për të dhënë informacion nga pikëpamja e tyre duke përdorur fjalët e tyre në një mënyrë relativisht të pa ndërprerë.

Gjyqtarët duhet të jenë shumë të kujdesshëm për të shmangur pyetje që përmbajnë informacion keq udhëzues për të mos dëmtuar kujtimet e fëmijëve.

Gjykata ka rol aktiv në hetimin dhe shqyrtimin e çështjes lidhur me mbrojtjen e interesit më të mirë të të miturve të cilët përfshihen në procedurën e shkurorëzimit që zhvillohet në mes të prindërve të tyre.

Nga ana e trajnuesve u dha edhe si rekomandim që në trajnimet e radhës në kuadër të përfituesve të marrin pjesë edhe zyrtarë nga Qendra për Punë Sociale sepse do të ishte një kombinim i mirë i përfituesve, ku njëherë edhe ata do të përfitonin nga ky trajnim.

Të gjithë të pranishmit e përfunduan debatin me një përshtypje të përgjithshme se trajnimi ishte produktiv dhe i dobishëm. Në fund, Kryetari Totaj dhe gjyqtari Sallauka falënderuan pjesëmarrësit për angazhim konstruktiv, si dhe falënderuan Akademinë e Drejtësisë për organizmin e trajnimit.

Në trajnim morën pjesë 43 pjesëmarrës, 25 prej tyre ishin gjyqtarë dhe 18 zyrtarë nga Agjencia për Ndihmë Juridike Falas.

Trajnim: Program i Specializuar i trajnimit-Krimi i Organizuar- Sesioni III



Më 07-08 Shtator 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme në bashkëpunim me Iniciativën për Sundimin e Ligjit në Ballkanin Perëndimor (WBROLI) i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Madhe dhe Ambasada e Mbretërisë së Madhe është realizuar trajnimi me temë “Program i Specializuar i Trajnimit Krimi i Organizuar – Sesioni III”.

Trajnimi u realizuar nga Ekspert ndërkombëtar z. Richard Gould – Ekspert nga Britania Madhe, z. Pedro Gomes Pereira – Ekspert dhe vendor z. Bashkim Hyseni, Gjyqtar në Gjykatën e Apelit.

Në ditën e parë trajnimi u përqendrua në strategjitë e hetimit për prokurorët. Në këtë kuadër u diskutua për parimet e hetimit sipas të cilave hetuesi duhet të respektoj etiken profesionale në të gjitha rastet pa përjashtim ndaj të dyshuarve, personave të ndjeshëm ose fëmijë. Vëmendje e veçantë iu kushtua alternativave të ndjekjes penale, bashkëpunimit me agjencitë partnere, organet ndërkombëtare, agjencitë që mund të ndihmojnë në sigurimin e informacionit, inteligjencës dhe provave. Për gjitha çështjet e trajtuara u ilustruan me shembuj praktik dhe ushtrime në grup të cilët më pas ndanë përvojat e tyre në lidhje me situata të caktuara.

Në ditën e dytë trajnimi u fokusua në shpjegimet e hollësishme sa i përket rrjeteve ndërkombëtare të kontrolluesve me theks te lëvizja ndërkombëtare e parasë nga grupet e krimin të organizuar. Në këtë kuadër u ofruan shpjegimet e nevojshme sa i përket rolit dhe funksionit të rrjetit, kodet dhe regjistrimet. Vëmendje e veçantë iu kushtua sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë duke u përqendruar në Instrumente e krimin dhe produktet, Strategjitë për rikuperimin e aseteve, Menaxhimi i pasurisë së sekuestruar, Standardet ndërkombëtare për konfiskimin (të avancuara nga FATF, BE dhe CoE) dhe qasjet globale për rikuperimin e pasurisë kriminale si dhe Konfiskimi – çfarë duhet vërtetuar apo treguar.

Edhe në ditën e dytë çështjet e trajtuara u ilustruan me shembuj praktik dhe ushtrime në grup të cilët më pas ndanë përvojat e tyre në lidhje me situata të caktuara.

Kjo doli të ishte një metodë shumë efektive, pasi pothuajse të gjithë pjesëmarrësit ishin të angazhuar në disa raste praktike.

Të gjithë të pranishmit e lanë debatin me një përshtypje të përgjithshme se trajnimi ishte produktiv dhe i dobishëm. Në fund, trajnuesit falënderuan pjesëmarrësit dhe angazhim konstruktiv, si dhe falënderuan Akademinë e Drejtësisë për organizmin e trajnimit.

Ky trajnim e vijuan 22 pjesëmarrës. Prej tyre 15 gjyqtarë, 4 prokurorë dhe 3 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor nga gjyqësori dhe prokuroria.

Trajnim: Kodi i Etikes dhe sjelljes profesionale të prokurorëve



Më 07 shtator 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar një trajnim për prokuror të nivelit themelor për Kodin e Etikës dhe sjelljes profesionale të prokurorëve.

Ashtu siç ishte paraparë, trajnimi ofroi mundësinë, për të diskutuar për parimet bazë të etikës profesionale të prokurorëve duke elaboruar në mënyrë të hollësishme pavarësinë e prokurorit, si duhet të veprojë në mënyrë të pavarur gjatë ushtrimit të funksionit të tij në përputhje me Kushtetutën, ligjet dhe vlerësimin e lirë të fakteve, pa kufizime, ndërhyrje, presion ose kërcënim nga çdokush dhe për çfarëdo arsye.

Në cilësi të trajnuesit ishte Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës z. Jetish Maloku, i cili ofrojë konceptet themelore të Kodit të etikës dhe sjelljes profesionale të prokurorëve duke e zbërthyer edhe ilustruar me raste hipotetike. Përmes këtyre rasteve vuri në pah situatat ose edhe sjelljet të cilat janë në kundërshtim me Kodin e etikës dhe ato që janë në pajtim me Kodin e Etikës. Gjithashtu trajnuesi parashitri pyetje për pjesëmarrësit të cilët më pas ndanë përvojat e tyre në lidhje me situata të caktuara. Metodologjia u vlerësua efikase pasi pothuajse të gjithë pjesëmarrësit ishin të angazhuar në diskutime. Rrjedhimisht, disa konkluzione dhe rekomandime të përgjithshme u nxorën nga ky trajnim dhe janë si në vijim:

Në raste kur prokurori ballafaqohet me rrethana, në të cilat nuk është e qartë se si të veprojë, është e rëndësishme që prokurori t'i diskutojë dilemat me eprorin e tij, me ndonjë koleg ose me ndonjë person në të cilin ka besim;

Prokurori duhet të veprojë në mënyrë të pavarur gjatë ushtrimit të funksionit të tij, në përputhje me Kushtetutën, ligjet dhe vlerësimin e lirë të fakteve, pa kufizime, ndërhyrje, presion ose kërcënim nga çdokush dhe për çfarëdo arsye.

Prokurori duhet të sigurojë të drejtat e të gjithë personave gjatë ushtrimit të funksionit në vazhdimësi për të qenë të barabartë përpara ligjit dhe të veprojë me objektivitet e paanshmëri, duke shmangur çdo diskriminim dhe paragjykim në lidhje me përkatësinë politike, etnike, sociale, kulturore, fetare ose gjinore, orientimin seksual, moshën, statusin, paaftësinë fizike apo mendore.

Prokurori duhet të jetë tolerant dhe i hapur për diskutime dhe zgjidhje të ofruara në mënyrë të ligjshme dhe të marrë parasysh pikëpamjet, interesat ligjore, jetën private dhe shqetësime të tjera të personave, që i kontakton gjatë punës së tij zyrtare;

Prokurori duhet të shmangë çdo aktivitet, i cili ndikon negativisht në paanshmërinë e tij gjatë kryerjes së funksionit si prokuror, të mbledhë mjete financiare, të japë këshilla juridike në lidhje me investimet financiare dhe të japë kontribut financiar për subjektet politike;

Prokurori duhet t'i shmangë diskutimet publike dhe nënshkrimin e peticioneve që mund të kenë ndikim në ndonjë vendim politik;

Interesi personal i prokurorit duhet t'i nënshtrohet interesit publik dhe nuk mund të udhëhiqet nga interesi i tij personal dhe nga motive të papërshtatshme.

Integriteti është cilësi e prokurorit, e cila duhet të jetë e dukshme dhe e njohur gjatë tërë kohës në harmoni me veprimet e tij, të bazuara në karakterin e lartë moral dhe profesional. Të vepruarit me integritet për një prokuror do të thotë të punojë dhe të jetë përgjegjës për veprimet dhe mosveprimet e tij në jetën profesionale dhe private.

Prokurori duhet të ketë qëndrim dhe qasje të paanshme gjatë ushtrimit të detyrave të tij në çdo kohë. Prokurori nuk duhet të veprojë në bazë të interesave personale, interesave apo preferencave të personave të njohur, anëtarëve të familjes ose interesave Prokurori i Shtetit Državni Tužilac State Prosecutor 13 të bizneseve apo interesave politike. Për më tepër, në asnjë rast nuk duhet që interesat personale ta

udhëheqin atë në avokimin e ndonjë pozicioni, i cili është në kundërshtim me faktet dhe ligjin e zbatueshëm;

Llogaridhënia dhe transparenca janë vlera themelore për prokurorin, të cilat nënkuptojnë kryerjen e detyrave në nivel të lartë, profesional, të përgjegjshëm, transparent dhe efikas. Prokurori duhet të japë llogari gjatë ushtrimit të funksionit dhe për mënyrën e ushtrimit të tij. Prokurori gjatë ushtrimit të funksionit të tij, prioritet ka detyrën e prokurorit, kundrejt aktiviteteve të tjera.

Prokurori është në kontakt të vazhdueshëm me qytetarët, prandaj institucioni i Prokurorit të Shtetit është i arritshëm dhe i afërt për mediat. Për prokurorët, kjo nënkupton se gjithmonë duhet të marrin parasysh faktin se një rast në të cilin kanë qenë duke punuar mund të shfaqet në media. Kjo nënkupton gatishmërinë për të qenë transparent në lidhje me rastin nëse një gjë e tillë kërkohet nga udhëheqësit. Gjatë paraqitjeve në media, prokurori duhet të përmbahet nga dhënia e informatave lidhur me rastet konkrete përveç rasteve kur ka autorizim për një gjë të tillë.

Në trajnim morën pjesë 7 (shtatë) prokurorë duke përfshirë edhe 1 (një) gjyqtarë

Trajnim: Risitë e Kodit të procedurës penale

Me 8-9 shtator si dhe 29-30 shtator 2023, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me US -DOJ/OPDAT - OSBE, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin me temë “Risitë e Kodit të Procedurës Penale” për regjionin e Gjakovës dhe regjionin e Prishtinës.

Qëllimi i trajnimeve ishte që pjesëmarrësit të njoheshin me risitë esenciale të Kodit të Procedurës Penale të cilat kanë tendencë për ndryshime të nevojshme dhe efektive. Dhe zbatimin e drejtë të tyre në praktikë.

Trajnimit u orientua në ndryshimet sa i përket hedhjes së kallëzimit penal që reflekton në mundësinë e ankesës ndaj hedhjes së kallëzimeve penale nga Prokurori Shtetit, pasi që më parë nuk lejohej ankesë ndaj hedhjes së kallëzimit qoftë nga ana e parashtruesit apo të dëmtuarit nga vepra penale.

Në vijim të risive ligjore u fol edhe për Mbrojtësin e detyruar, mbrojtësin me shpenzime publike dhe kur mbrojtja nuk është e detyruar dhe të drejtat e të dëmtuarit ose viktimës, të drejtën për të apeluar aktvendimin, masat e veçanta hetimore, mbrojtja e dëshmitarëve, marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklarata në procedurë paraprake, mundësia hetuese e veçantë, hetimi (afati i hetimeve, pushimi dhe rihapja e hetimeve). Trajtimi i këtyre çështjeve është bërë duke prezantuar

sfidat e identifikuara në praktikën e gjykatave dhe prokurorive.

Në këtë trajnim u trajtua edhe Marrëveshja për pranimin e fajësisë dhe dëshmitarët bashkëpunues, qasja publike në aktakuzë dhe publikimi i aktgjykimit. Ndër të tjera u shtjellua edhe Shqyrtimi i dytë, aktakuza e konfirmuar dhe caktimi i shqyrtimit gjyqësor duke u vazhduar me standardin e rishikimit të ankesave shkeljet substanciale, ndryshimi i aktgjykimit nga Gjykata e Apelit, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, sekuestrimi dhe konfiskimi si dhe procedura penale ku përfshihen kryesit me çrregullime mendore.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar me raste praktike.

Pjesëmarrës të trajnimit të dates 8-9 shtator ishin gjyqtarët, prokurorët dhe bashkëpunëtorët profesional nga regjioni i Mitrovicës dhe Ferizajit. Këtë trajnim e vijuan 27 pjesëmarrës. Prej tyre 3 gjyqtarë, 5 prokurorë si dhe 19 bashkëpunëtorë të gjykatave dhe prokurorive.

Pjesëmarrës në trajnimin e dates 29-30 shtator ishin gjyqtarët dhe prokurorët nga regjioni i Ferizajit dhe Gjlanit. Këtë trajnim e kanë vijuar 28 pjesëmarrës. Prej tyre 7 gjyqtarë, 10 prokurorë si dhe 10 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor nga regjioni i Ferizajit dhe 1 zyrtarë I ndihmës juridike falas.



Trajnim për interpretimin dhe zbatimin e nenit 430 të Kodit Penal dhe Ligjit për Deklarimin e Pasurive, si dhe diferencimi i raportimit të rremë me falsifikim të dokumenteve



Më 12 shtator 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar për gjyqtar dhe prokuror të nivelit Themelore: “Trajnim për interpretimin dhe zbatimin e nenit 430 të Kodit Penal dhe Ligjit për Deklarimin e Pasurive, si dhe diferencimi i raportimit të rremë me falsifikim të dokumenteve”. Ky trajnim u realizua në Akademinë e Drejtësisë dhe në të morën pjesë 9 pjesëmarrës.

Ashtu siç ishte paraparë, trajnimi ofroi mundësinë, për të diskutuar për Deklarimin e pasurisë që konsiderohet si një ndër aspektet bazë në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në të gjitha nivelet. Fokusi ishte tek interpretimi i nenit 430 të Kodit Penal dhe ligjit për deklarimin e pasurisë me theks te Paragrafi 1 i këtij neni i cili thotë: “Çdo person, i cili sipas ligjit është i detyruar të bëjë deklarimin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, dhe i cili nuk bën një gjë të tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet. Vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni konsiderohet se është kryer kur deklarata nuk paraqitet brenda afatit për paraqitjen e deklaratës”.

Paragrafi 2 i këtij neni thotë: “Çdo person, i cili sipas ligjit është i detyruar të bëjë deklarimin e pasurisë, të të ardhurave, të dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, i cili bën deklaratë të rreme ose nuk paraqet të dhënat e kërkuara në deklaratë, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet. Gjobat e shqiptuara sipas këtij neni mund të jenë ditore dhe mund të shqiptohen derisa kryesi të përfill urdhrin, vendimin apo aktgjykimin e plotfuqishëm që është subjekt i veprimit”.

Pjesëmarrësit gjatë trajnimit patën mundësinë e parashtrimit të pyetjeve të ndanë përvojat e tyre në lidhje me situata të caktuara.. Rrjedhimisht, disa konkluzione dhe rekomandime të përgjithshme u nxorën nga trajnimi dhe janë si në vijim:

Në raste kur zyrtari i larte publik ka dilema se si duhet të behet deklarimi i pasurisë bazuar në legjislacionin në fuqi është e drejt e tije ti drejtohet Agjencisë për të marr informacionet e nevojshme për procesin e deklarimit të pasurisë;

Zyrtari publik duhet ta kenë parasysh që deklarimi i pasurisë duhet të bëhet me kohë duke respektuar afatin 15 ditor pas datës së fundit për deklarim të pasurisë nga se nga ai moment mund të futen në veprime inkriminuese që kanë përgjegjësi penale.

Zyrtarët publik që deklarojnë pasurinë dilema kane rreth dashjes si element të veprës penale se a kryhet kjo veper penale vetëm me dashje.

Pastaj çështje tjetër me interes ka qenë nga pjesëmarrësit në trajnim ka qene çështja e deklarimit të pasurisë të personave që jetojnë në bashkësi familjare përfshirë edhe nusen e djalit dhe vjehrrin.

Pastaj nëse zyrtari publik deklarimin e pasurisë së rrem e ka bere duke falsifikuar dokumentin

zyrtar a inkriminohet edhe ky veprim si vepër penale.

Si përfundim mund të konstatojmë se ka qene një bashkëbisedim rreth formave të deklarimit të pasurisë, dallimit ndërmjet procedurës administrative tek agjencia dhe dyshimit për veper penale, pastaj dënimet administrative dhe dënimet që mund ti shqiptoj gjykata, a është publikimi i pasurisë së anëtareve të familjes ndërhyrje në jetën private pasi që nuk janë subjekte deklaruese.

Trajnimin e vijuan 9 pjesëmarrës. Prej tyre 7 gjyqtarë dhe 2 prokuror kryesisht nga niveli themelor.

Trajnim për praktikën gjyqësore në çështjet nga procedura kontestimore



Më 12 -13 shtator 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi në formë tryeze me gjyqtar nga niveli Themelore dhe i Apelit si dhe gjyqtar nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, për praktikën gjyqësore në çështjet nga Procedura Kontestimore.

Ky trajnim u mbajt në Akademinë e Drejtësisë dhe në të morën pjesë rreth 25 (njëzetepesë) pjesëmarrës.

Ashtu siç ishte paraparë, trajnimi ofroi mundësinë pjesëmarrësve, për të diskutuar për: Parimet e procedurës kontestimore, kompetencën dhe llojet e saj, shqyrtimin paraprak të padisë dhe përgjigjen në padi, arsyet për përjashtimin e gjyqtarit. Më tej u vazhdua me seancën përgatitore dhe kryesore dhe si bëhet përfundimi i procedurës me vendim të gjykatës. Nga trajnuesit u elaboruan edhe llojet e aktgjyqimeve sipas LPK-se, mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të goditjes, mjetet provuese dhe marrja e provës, dëshmitarët ekspertet dhe palët. Gjatë këtij trajnimit u diskutua edhe për ndërprerjen dhe pushimin e procedurës kontestimore si dhe

procedurat e posaçme kontestimore.

Gjatë këtij trajnimi u adresuan gjitha sfidat e praktikës gjyqësore lidhur me çështjet e lartpërmendura nga procedura kontestimore dhe njëherësh u zhvillua debat konstruktiv me pjesëmarrësit të cilët më pas ndanë përvojat e tyre në lidhje me situata të caktuara. Rrjedhimisht, disa konkluzione dhe rekomandime të përgjithshme u nxorën nga trajnimi lidhur Procedurën kontestimore dhe janë si në vijim:

Cenohet parimi i kontradiktoritetit (neni 5 LPK) gjithmonë kur gjykata pamundëson që secila palë të informohet për veprimet e ndërmarra procedurale të palës tjetër kundërshtare, sidomos me mos dërgim të shkresave të ndryshme të lëndës ose edhe të mjeteve provuese.

Për kompetencën territoriale të gjykatës, gjykata nuk kujdeset sipas detyrës zyrtare, përveç kur është fjala për kompetencën ekskluzive territoriale.

Me rastin e këqyrjes në vend, gjyqtari i çështjes përveç tjerave, gjithmonë në procesverbal duhet të konstatoj gjendjen faktike ekzistuese të sendit-objekt i shikimit të drejtpërdrejtë, për shembull, patundshmëria a është me të mbjella, me çfarë të mbjellash, a është e lirë, a ka objekte të ndërtruara në te, a është e rrethuar me mur, tela si dhe fakte tjera të rëndësishme për të gjykuar në atë çështje juridike.

Me rastin e dëgjimit të dëshmitarit, duke u bazuar në parimin e të vërtetës materiale, gjithmonë duhet pyetur dëshmitarin se kah e ka informacionin, a ka parë, a ka dëgjuar, a i ka thënë direkt dikush, etj, me qëllim të vërtetimit

të objektivitetit dhe kredibilitetit të dëshmisë së dëshmitarit.

Të gjithë të pranishmit e përfunduan trajnimin me një përshtypje të përgjithshme se trajnimi ishte produktiv dhe i dobishëm duke qenë mirënjohës trajnuesve dhe Akademisë së Drejtësisë për organizmin e trajnimit.

Pjesëmarrës në këtë tryezë ishin 31 gjyqtarë. Prej tyre 3 nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, 1 nga Gjykata e Apelit dhe 27 të tjerë nga niveli themelo i gjykatave nga të gjitha regjionet e Kosovës.

Trajnim: Masat dhe dënimet që shqiptohen ndaj të miturve

Më 14 shtator 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Masat dhe dënimet ndaj të miturve.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive sa i përket masave dhe dënimeve ndaj të miturve dhe zbatimi i tyre në praktikë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky trajnim trajtoj masat e diverzitetit dhe masat edukative të cilat janë pjesë përbërëse e punës praktike të prokurorit dhe gjyqtarit për të mitur. Zbatimi i tyre siq u tha është me interes të posaçëm për të miturin që ka ra ndesh me ligjin dhe po ashtu edhe për shoqërinë duke pasur parasysh personalitetin e delikuinteve të mitur që dallohen nga kryesit e sjelljeve kriminale të rritur, vetitë e tyre bio psikike, psikofizike dhe socio kulturore.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar llojeve të masave edukuese si qortimit, gjyqësor, mbikëqyrjes së shtuar institucionale si mundësi për t’iu shqiptuar kryerësve të mitur si zgjidhje

pragmatike, kjo për faktin se institucioneve përkatëse u ofrohet mundësia që të orientohen drejt shqiptimit të asaj mase me të cilën konsiderohet se arrihet me lehtë qëllimi i edukimit, rehabilitimit dhe zhvillimit të drejtë i të miturit në mënyrë që i mituri të bëhet një person i dobishëm për vetën, familjen dhe shoqërinë.

Po ashtu u diskutua edhe për dënimet dhe llojet e vendimeve gjyqësore.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive i shoqëruar me shembuj praktik ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikë me rastin e shqiptimit të masave apo të dënimeve ndaj të miturit që ka rënë ndesh me ligjin.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 5 gjyqtarë nga departamenti për të mitur dhe departamenti i përgjithshëm. Prej tyre 1 nga Apeli dhe 4 të tjerë nga niveli themelor.



Trajnim: Njohuritë financiare

Më 21-22 Shtator 2023, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme në bashkëpunim me Drejtësinë Komerciale - USAID kanë realizuar trajnimin me temë “Njohuritë financiare”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me konceptet themelore të raporteve financiare për zgjidhjen e drejtë dhe meritore të kontesteve financiare nga ana e gjykatës.

Për dy ditë me radhë u diskutuan Elementet e pasqyrave financiare; Llojet e raporteve financiare dhe përdoruesit e tyre; Korniza e raportimit; Akterët dhe rolet specifike të akterëve në raportimin financiar global dhe në Kosovë; Vështrime nga sektori privat mbi kontestet tatimore dhe fiskale.

Në ditën e dytë pjesëmarrësit patën rastin që të diskutojnë edhe për kontestet financiare mes

operatorëve me impakt ekonomik, llojet e dëmeve gjatë transaksionit mes palëve, çështjet e përgjithshme tatimore e fiskale dhe koeficientet financiare.

Sa i përket koeficiente u tha që ndaheshin në 6 lloje: në koeficientet e likuiditetit, efikasitetit, slovences, mbulueshmërisë, fitimit dhe vlerës së tregut. Vëmendje iu kushtua vlerës në kohë të parasë që siq u tha nënkupton që ajo mund të rritet vetëm përmes investimit, kështu që një investim i vonuar është një mundësi e humbur.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar edhe raste praktike të përgatitura nga eksperti financiar, ku pjesëmarrësit patën rastin të ballafaqohen me probleme nga praktika.

Përfitues në këtë trajnim ishin 14 Gjyqtarët nga Gjykata Komerciale.



Tryezë: Sfidat në identifikimin/hetimin e trafikimit me njerëz në mesin e fëmijëve në situatë rruge

Më 22 Shtator 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme në bashkëpunim me Këshillin e Evropës - Projekti Forcimi i veprimeve anti-trafikim, është realizuar tryeza me temë - "Sfidat në identifikim/hetim të trafikimit me njerëz në mesin e fëmijëve në situatë e rruge".

Qëllimi i kësaj tryeze ishte identifikimi i sfidave në hetimin e trafikimit me njerëz, përkatësisht fëmijëve në situatë rruge dhe adresimi i tyre për zgjidhjen më të mirë të rasteve në gjykata.

Fokusi i kësaj tryeze ishte diskutimi i trafikimit i qenieve njerëzore me qëllim të shfrytëzimit për punë prandaj edhe gjatë tryezës u diskutua për nevojën që shtetet duhet të sigurojnë kushte në përputhje me të drejtat sociale që mbrojnë viktimat potenciale nga cenueshmëria dhe ti mbrojnë ata nga rreziku për tu bërë viktimë të trafikimit të qenieve njerëzore.

Vëmendje e veçantë iu kushtua dështimit të rregullimit të tregut të punës për të kontrolluar praktikat potencialisht të parregullta në tregun e punës duke mundësuar kështu rritjen e trafikimit të qenieve njerëzore me qëllim të

shfrytëzimit për punë.

Identifikimi i viktimave po ashtu ishte një nga çështjet kyçe të kësaj tryeze e cila domosdoshmërisht kërkon përparësi zbulimit të rasteve të trafikimit me qenie njerëzore për shfrytëzim dhe për punë. Rol të rëndësishëm në parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie ishte edhe mbështetja dhe mbrojtja e viktimave, qasja në kompensimin dhe mjetet e tjera juridike. Gjithashtu u fol edhe për dispozitat e mosndëshkimit që cenojnë mbrojtjen e fëmijëve viktimë të trafikimit me qenie njerëzore për shfrytëzim në punë. U ofruan edhe shpjegime sa i përket të kuptuarit e lidhjes shkak-pasoje midis shkëlqes së të drejtës së punës dhe trafikimit me qenie njerëzore për shfrytëzim në punë. Pjesëmarrësit e tryezës patën mundësinë e pyetjeve dhe diskutimeve të përbashkëta në lidhje me situatat e caktuara duke ndarë përvojën dhe perspektivën e tyre për këtë fushë.

Këtë tryezë e vijuan 19 pjesëmarrës, prej tyre 2 prokurorë, 4 mbrojtës të viktimave, 2 nga Qendra për punë sociale, 10 zyrtarë policor si dhe 1 zyrtarë nga Terre des hommes.



Trajnim: Hetimi financiar dhe rikuperimi i aseteve

Më 25-29 shtator 2023, në bashkëpunim me UNDP/SAEK në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi pese ditor me gjyqtar, prokuror, bashkëpunëtor profesional të nivelit themelore si dhe hetues policor me temë: Hetimi financiar dhe rikuperimi i aseteve.

Ky trajnim është realizuar në formë hibride me pjesëmarrje fizike ndërkaq është shfrytëzuar platforma e mësimit në distancë MOODLE në kuadër të cilës pjesëmarrësit kanë pasur qasje në materialet ligjore, testet dhe rastet praktike që janë përdorur gjatë trajnimit.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive lidhur me hetimin financiar dhe kthimin e aseteve, sa i përket hetimit të veprave penale të Korrupsionit nga kapitulli 33 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Shpëlarjes së parave dhe Kthimin e aseteve të fituara me vepër penale.

Trajnimi u fokusua në ofrimin e shpjegimeve të qarta si behet gjurmimi i aseteve dhe organizmi i provave elektronike. Pastaj u diskutua për elementet e Krimit bazuar në legjislacionin në fuqi, si behet qasja në hetime financiare. Vëmendje e veçantë iu kushtua metodës

interaktive për vërtetimin e të hyrave ilegale. Gjithashtu u trajtua ndihma e ndërsjellë juridike dhe cilët janë mekanizmat për konfiskim të aseteve.

Pjesëmarrësit patën mundësinë të aplikojnë drejtpërdrejtë përmes Platformës së mësimit në distancë të Akademisë së Drejtësisë, teknikën sa i përket hetimit të veprave penale të Korrupsionit nga kapitulli 33 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Shpëlarjes së parave dhe Kthimin e aseteve të fituara me vepër penale.

Të gjithë të pranishmit e përfunduan trajnimin me një përshtypje të përgjithshme se trajnimi ishte produktiv dhe i dobishëm. Në fund, trajnuesit falënderuan pjesëmarrësit dhe angazhim konstruktiv, si dhe falënderuan Akademinë e Drejtësisë për organizimin e trajnimit.

Këtë trajnim e vijuan 15 pjesëmarrës. Prej tyre 2 gjyqtarë, 4 prokurorë si dhe 3 bashkëpunëtorë profesional, 2 referentë të lartë nga gjykatat dhe prokuroritë e nivelit themelor si dhe 4 zyrtarë policor



Trajnim: Zbatimi dhe specifikat e instrumenteve ndërkombëtare, Direktivave dhe Rregulloreve të UE-së mbi çështjet komerciale dhe doganore

Sot më 26 shtator 2023, Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme ka realizuar trajnimin nga fusha komerciale me temë: “Zbatimi dhe specifikat e Instrumenteve ndërkombëtare, Direktivave dhe Rregulloreve të UE-së mbi çështjet komerciale dhe doganore”.

Trajnimi është dizajnuar për të shënjestruar ngritjen e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe stafit mbështetës në adresimin e rasteve me element të huaj, të cilat potencialisht kërkojnë zbatim të instrumenteve ndërkombëtare apo atyre të UE-së.

Gjatë trajnimit është shtjelluar Konventa për Shitjen Ndërkombëtare të mallrave si njëri nga instrumentet më të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e së drejtës komerciale dhe aspekte

të rëndësishme për punën e gjyqtarëve në rastet të tilla. Vëmendje e veçantë i është kushtuar çështjeve komerciale, doganore e fiskale në kuadër të UE-së, me theks të veçantë ato që kanë ndikim në shtetet e treta. Po ashtu u diskutua për kufijtë e fushëveprimit territorial dhe substancial të secilit instrument.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit patën rastin të diskutojnë edhe raste praktike përmes të cilave u shkëmbyen përvojat dhe perspektivat ndërmjet tyre për aspektet e rëndësishme si të kornizës ligjore ashtu edhe zbatimit praktik të tyre.

Këtë trajnim e vijuan 5 gjyqtarë, 3 nga Gjykata Komerciale dhe 2 nga Gjykatat Themelore.



Trajnim: Aksidentet në trafik

Më 28 shtator 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi për gjyqtarë, prokurorë si dhe për bashkëpunëtorë profesional kryesisht të nivelit themelor me temën e lartpërmendur.

Ashtu siç ishte paraparë, trajnimi ofroi mundësinë për elaborimin e aksidenteve në trafik si rezultat i shpejtësisë e palejuar, tejkalimi, anashkalimit dhe përballë-kalimit. Me rastin e këtij trajnimi u trajtuan dispozitat ligjore të rastet e aksidenteve në trafik, dispozitat ligjore në përcaktimin e përgjegjësisë kundërvajtëse për kundërvajtjet nga lëmia e trafikut rrugor.

Gjatë trajnimit u potencua se Aktgjykimi mbi kundërvajtjet duhet patjetër të ketë për bazë përshkrimin e kundërvajtjes të paraparë në kërkesën e organit dhe nuk mund të dalë nga korniza respektivisht ngjarja e përshkruar në kërkesë. Mirëpo gjyqtari për kundërvajtje nuk është i lidhur me propozimet e paraqitura në kërkesë, në aspektin e nxjerrjes së provave, cilësimi juridik të kundërvajtjes. Deri te ndryshimi i cilësimit juridik të kundërvajtjes vjen nëse gjyqtari i kundërvajtjes nga të njëjtat fakte nxjerrë konkludim tjetër ligjor, e që kualifikimi ligjor nga ana e paraqitësit të kërkesës mund të jetë i gabuar. Nëse gjyqtari për kundërvajtje nuk e pranon kualifikimin ligjor të përcaktuar në kërkesën e organit në aktgjykim mbi kundërvajtje me të cilin të pandehurin e shpall përgjegjës

e përcakton cilësimin juridik të kundërvajtjes që ai e konsideron si ligjor.

Metodologjia u vlerësua efikase pasi pothuajse të gjithë pjesëmarrësit ishin të angazhuar në ligjërata interaktive me prezantime në Power-Point, raste hipotetike të përgatitura nga trajnuesi ku pjesëmarrësit patën rastin të ballafaqohen me probleme nga praktika.

Diskutimin e ka karakterizuar një frymë e lartë e profesionalizmit dhe një përkushtim i admiruar që nga puna në grupe e deri tek zhvillimi i debatit për secilën çështje të diskutuar.

Rrjedhimisht, disa rekomandime të përgjithshme u nxorën nga ky trajnim që në të ardhmen të trajtohen edhe këto tema dhe janë si në vijim:

Procedura Kundërvajtëse, Personat juridik si kryes të kundërvajtjes, Veprat Kundërvajtëse nga Lëmia e Trafikut, Veprat Kundërvajtëse nga Rendi dhe Qetësia Publike etj.

Të gjithë të pranishmit e përfunduan debatin me një përshtypje të përgjithshme se trajnimi ishte produktiv dhe i dobishëm. Në fund trajnuesi falënderoi pjesëmarrësit për angazhim konstruktiv, si dhe falënderoi Akademinë e Drejtësisë për realizimin e këtij trajnimi.

Në trajnim morën pjesë 20 pjesëmarrës. Prej tyre 16 gjyqtarë, 2 prokurorë si dhe 2 bashkëpunëtorë profesional.



Aktivitetet trajnuese për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive

Trajnim: Shkathtësitë për hartimin e aktakuzës - Mentorim për bashkëpunëtorët profesional



Më 12-13 shtator 2023, Akademia e Drejtësisë në kuadër Programit për Trajnime të Vazhdueshme në bashkëpunim me Iniciativën për Sundimin e Ligjit në Ballkanin Perëndimor (WBROLI) i financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Madhe dhe Ambasada e Mbretërisë së Madhe në Prishtinë, kanë realizuar trajnimin për bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Themelore, Departamenti Special dhe të Prokurorisë Speciale.

Ashtu siç ishte paraparë, trajnimi ofroi mundësinë pjesëmarrësve për të diskutuar për: fazat e hetimit, rolin dhe detyrat e prokurorit, detyrat dhe përgjegjësisë në gjykatë, vendimi për aktakuzë, hyrje në aktakuzë, rëndësinë e argumentimit me shkrim, hyrje në strukturën e argumentimit.

Në mënyrë të hollësishme u elaboruan hartimi i aktakuzave për veprat e vrasjeve, veprat seksuale, veprat e mashtrimit, prezantimin e provave p.sh provat digjitale, bashkëpunimi, krimi i organizuar, tregimi i ngjarjes dhe bartja e porosisë, pranueshmëria, përpilimi i dokumenteve për të përmbledhur materialin, duke theksuar që aktet akuzuese nga Prokuroria Speciale të kenë rrjedhë të mirë dhe të shqyrtohen nga Departamenti Special i Gjykatës Themelore me theks të jenë të përpiluara mirë, të përmbajnë arsyetimin e mirë dhe të argumentuara me prova.

Në cilësi të trajnuesve ishin ekspertët ndërkombëtar z. John McKendrick KC dhe z. Oliver Powell të cilët sipas rendit të ditës, trajtuan temat e tyre të përgatitura më parë.

Gjithashtu trajnuesit parashtruan pyetje për pjesëmarrësit të cilët më pas ndanë përvojat e tyre në lidhje me situata të caktuara. Metodologjia u vlerësua efikase pasi pothuajse të gjithë pjesëmarrësit ishin të angazhuar dhe të përfshirë në diskutime interaktive, raste studimore dhe prezantime të rasteve dhe njëherit patën rastin në grupe të bënin përpilimin e aktakuzave.

Rrjedhimisht, disa konkluzione dhe rekomandime të përgjithshme u nxorën nga ky trajnim dhe janë si në vijim:

Prokurorët të jenë të barabartë në qasjen e tyre ndaj çdo rasti dhe kanë për detyrë t'i mbrojnë të drejtat e të dyshuarve dhe të pandehurve, duke ofruar shërbimin më të mirë të mundshëm për viktimat.;

Çdo material të ndjeshëm të cili e posedon prokuroria nuk duhet të jepen të pandehurit.

Prokurorët duhet të veprojnë gjithmonë në interes të drejtësisë dhe jo vetëm me qëllim të marrjes së një dënimi.

Prokurorët duhet të jenë të lirë t'i kryejnë

detyrat e tyre profesionale pa ndërhyrje politike dhe nuk duhet të preken nga presioni ose ndikimi i pahijshëm ose i panevojshëm nga çfarëdo burimi.

Nga ana e pjesëmarrësve u dha edhe si rekomandim për trajnuesit që në trajnimet e radhës në kuadër të përfituesve të marrin pjesë në raste stimulimi në gjykatë dhe të bëjnë shkëmbimin e përvojave rreth seancave gjyqësore me Mbretërinë e Madhe.

Të gjithë të pranishmit e përfunduan debatin me një përshtypje të përgjithshme se trajnimi ishte produktiv dhe i dobishëm. Në fund ekspertët falënderuan pjesëmarrësit për angazhim konstruktiv, si dhe falënderuan Akademinë e Drejtësisë për bashkëpunimin e ndërsjellët që kanë me Chemonics.

Trajnimi e vijuan 16 bashkëpunëtorë profesional. Prej tyre 10 nga Prokuroria Speciale dhe 6 nga Gjykata Themelore Prishtinë, Departamenti Special.

Trajnim: Moduli bazik-aspekti penal material - Pjesa e përgjithshme dhe e posaçme e së drejtës penale –Grupi IV



Më 18 – 20 Shtator 2023, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me SAEK, ka realizuar 3 trajnime për Grupin e IV nga Moduli Bazik për bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjor me temë “Pjesa e përgjithshme dhe e posaçme e së drejtës penale”.

Për të mundësuar pjesëmarrjen në trajnime të gjithë bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive që punojnë në fushën penale, Akademia e Drejtësisë trajnimet në fushën penale materiale i ka nda në 3 ditë trajnimi.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive lidhur me kornizën ligjore në fushën penale dhe zbatimin e drejtë në praktikën gjyqësore për zgjidhjen meritore të rasteve.

Në kuadër të këtyre sesioneve trajnuese nga pjesa e përgjithshme e së drejtës penale u diskutua për parimet e përgjithshme në zbatimin e Ligjit më të favorshëm me fokus te vlerësimet lidhur me zbatimin e ligjit më të favorshëm, Cilësia e kryerësve - kuptimi i personit zyrtar dhe Politika ndëshkimore për veprat penale te korrupsionit si dhe Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale si dhe veprat penale nga Kapitulli XXVI, Kapitulli XXIII, Kapitulli XXX dhe Kapitulli XXIX të KPK-se.

Në kuadër të këtyre trajnimeve u diskutua për

shkaqet e përjashtimit të kundërligjshmërisë me theks te mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme, dhuna dhe kanosja, vepra e rëndësisë së vogël dhe përgjegjësia penale. Në kuadër të pjesës së posaçme është diskutuar për veprat penale kundër jetës dhe trupit me theks te vrasja dhe vrasja e rëndë si dhe për veprat penale kundër integritetit seksual duke trajtuar me vëmendje të veçantë aspekte të rëndësishme të dhunimit dhe sulmit seksual.

Në veçanti u trajtuan Politikat ndëshkimore për veprat penale te korrupsionit si keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, konflikti i interesit, përvetësimi dhe mashtrimi ne detyre, marrja e ryshfetit dhe dhënia e ryshfetit, nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore dhe zbulimi i fshehtësisë zyrtar. Gjithashtu u elaboruan rrethanat renduese dhe rrethanat lehtësuese për matjen e dënimit, ndalimi i dyfishimit te rrethanave për matjen e dënimit si dhe faktorët specifik te rrethanave për ta peshuar me rastin e matjes se dënimit.

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit patën rastin që përmes rasteve të shumta studimore të bashkëpunimit në kryerjen e veprave penale dhe ndihmës në kryerjen e veprave penale të diskutojnë dhe të japin opinione ligjore dhe njëkohësisht të zbërthejnë dispozitat ligjore.

18 shtator 2023, Përfitues në trajnimin ishin 16 pjesëmarrës, prej tyre ishin 11 bashkëpunëtorë profesional, 5 zyrtar ligjor.

19 shtator 2023, Përfitues në trajnimin ishin 15 pjesëmarrës, prej tyre 9 bashkëpunëtorë profesional, 6 zyrtar ligjor.

20 shtator 2023, Përfitues në trajnimin ishin 11 pjesëmarrës prej tyre 7 bashkëpunëtorë profesional, 4 zyrtar ligjor.

Trajnim: Moduli bazik-aspekti penal procedural-Grupi IV

Më 22, 26 dhe 27 Shtator 2023, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me SAEK, ka realizuar 3 trajnime për Grupin e IV nga Moduli Bazik për bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjor. Trajnimet janë realizuar në 3 pjesë me temat “Fazat e procedurës penale, Mjetet Juridike dhe procedurat e veçanta si dhe Aktakuza - shqyrtimi gjyqësor dhe arsyetimi”. Trajnimet në procedurën penale e kanë vijuar të gjithë pjesëmarrësit të cilët i kanë përfunduar trajnimet në pjesën penale – materiale.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive lidhur me kornizën ligjore në fushën penale dhe zbatimi i drejtë në praktikën gjyqësore.

Në kuadër të këtyre sesioneve trajnuese u diskutua për parimet, kompetencën dhe palët në procedurën penale, Veprimet parapenale dhe fazat e procedurës penale, Masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit në procedurën penale, Fazat e procedurës penale, Aktakuza, shqyrtimi gjyqësor dhe arsyetimi.

Gjtë këtyre trajnimeve u trajtuan: Kallëzimi penal, procedura paraprake, Aktvendimi për hudhje të kallëzimit penal, aktvendimi për

fillimin e hetimeve, Aktvendimi për zgjerimi të hetimeve si dhe Aktvendimi për pushim të hetimeve. Në vazhdim u trajtuan Mjetet juridike, administrimi i procedurës, procedura për dhënien e urdhërit ndëshkimor si procedurë e veçantë si dhe procedura e shlyerjes së dënimeve nga evidenca. Në veçanti u trajtua Shqyrtimi gjyqësor dhe aktgjykimi.

Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit patën rastin që përmes rasteve nga praktika gjyqësore, përmes pune s ne grupe te hartojnë vendimet gjyqësore, të diskutojnë dhe të japin opinione ligjore dhe njëkohësisht të zbërthejnë dispozitat ligjore.

22 shtator 2023, Përfitues në trajnim ishin 10 pjesëmarrës, prej tyre 5 ishin bashkëpunëtorë profesional, 5 zyrtar ligjor.

26 shtator 2023, Përfitues në trajnim ishin 16 pjesëmarrës, prej tyre 10 bashkëpunëtorë profesional, 6 zyrtar ligjor.

27 shtator 2023, Përfitues në trajnimin ishin 20 pjesëmarrës prej tyre 9 bashkëpunëtorë profesional, 7 zyrtar ligjor.



Trajnim: Njohuritë financiare

Më 28-29 Shtator 2023, në mbështetje të Programit për Drejtësi Komerciale - USAID trajnimi i njëjtë i realizuar për gjyqtarë me temë: Njohuritë financiare është realizuar edhe për bashkëpunëtorë profesional të Gjykatës Komerciale. .

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të bashkëpunëtorëve profesional të kësaj gjykate lidhur me konceptet themelore të raporteve financiare për zgjidhjen e drejtë dhe meritore të kontesteve financiare nga ana e gjykatës.

Për dy ditë me radhë u diskutuan Elementet e pasqyrave financiare; Llojet e raporteve financiare dhe përdoruesit e tyre; Korniza e raportimit; Akterët dhe rolet specifike të akterëve në raportimin financiar global dhe në Kosovë; Vështrime nga sektori privat mbi kontestet tatimore dhe fiskale.

Në ditën e dytë pjesëmarrësit patën rastin që të diskutojnë edhe për kontestet financiare mes operatorëve me impakt ekonomik, llojet e dëm-

eve gjatë transaksionit mes palëve, çështjet e përgjithshme tatimore e fiskale dhe koeficientet financiare.

Sa i përket koeficiente u tha që ndaheshin në 6 lloje: në koeficientet e likuiditetit, efikasitetit, slovences, mbulueshmërisë, fitimit dhe vlerës së tregut. Vëmendje iu kushtua vlerës në kohë të parës që siq u tha nënkupton që ajo mund të rritet vetëm përmes investimit, kështu që një investim i vonuar është një mundësi e humbur.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar edhe raste praktike të përgatitura nga eksperti financiar, ku pjesëmarrësit patën rastin të ballafaqohen me probleme nga praktika.

Përfitues në këtë trajnim ishin 6 bashkëpunëtorë profesional të Gjykatës Komerciale.



Aktivitetet për trajnues

Trajnim i Trajnuesve – Gjykimi i Rasteve të Korrupsionit Publik

Më 05 shtator 2023, si rezultat i bashkëpunimit mes Akademisë së Drejtësisë dhe CEELI Institute është vazhduar sesioni i dytë i Trajnimit të Trajnuesve rreth Gjykimit të rasteve të korrupsionit publik.

Në kuadër të këtij sesioni përmes Lëvizjes FOL u formalizuar nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit mes Akademisë së Drejtësisë dhe Institutit CEELI, që si rezultat i tij do jenë edhe shumë aktivitete tjera të përbashkëta.

Ky trajnim i trajnuesve i cili është vazhdimësi e sesionit të parë të realizuar në Republikën

Çeke, ka për qëllim që ti zhvillojë dhe rritë aftësitë dhe kapacitetet profesionale të trajnuesve vendor në fushën e korrupsionit publik, duke gërshtuar edhe përvojën e gjyqtarëve nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Përfitues të trajnimit ishin trajnuesit vendor të AD-së, kryesisht 4 Gjyqtarë nga Gjykata e Apelit dhe Themelore nga Departamenti Special.



Trajnim i Trajnuesve – Arsyetimi i vendimeve gjyqësore

Me 19-20 shtator 2023, Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë, përkatësisht projekti “Mbështetje Gjykatës Kushtetuese në aplikimin dhe shpërndarjen e standardeve evropiane”, ka zhvilluar Trajnimin dy ditor për trajner rreth Arsyetimit të vendimeve gjyqësore..

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që trajnuesit vendor të familjarizohen me standardet ndërkombëtare rreth arsyetimit të vendimeve, me format dhe burimet duke u ballafaquar edhe me raste nga praktika.

Në fjalën e tij hyrëse Drejtori ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë falënderoj Këshillin e Evropës të cilët në mënyrë të vazhdueshme mbështesin Akademinë në përmirësimin e infrastrukturës ligjore dhe trajnuese duke u bazuar ne standardet e fundit ndërkombëtare. z. Fejzullahu theksoi se ky trajnim është vetëm një nismë e AD-së në përmirësimin dhe avansimin e kapaciteteve trajnuese në fushën e Arsyetimit të vendimeve gjyqësore, e cila do përcillet me një pako të trajnimeve në veçanti edhe në platformën HELP ku edhe do lansohet kursi online.

Gjatë trajnimit janë trajtuar Nenet 3 dhe 5 të KEDNJ-së në jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe gjykatave kombëtare, Nenet 6 dhe 8 në jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe gjykatave kombëtare si dhe Nenet 10 dhe 14 në jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe gjykatave kombëtare.

Në përfundim të trajnimit pjesëmarrësit patën rastin ta posedojnë edhe doracakun e ri të hartuar nga dy trajnuesit e angazhuar nga Këshilli i Evropës, znj. Ivana Roagna dhe z. Bekim Sejdiu rreth standardeve të fundit ndërkombëtare rreth Arsyetimit të vendimeve gjyqësore.

Përfitues të trajnimit ishin trajnuesit e AD-së si dhe trajnuesit potencial për të ardhmen përkatësisht 9 gjyqtarë, 3 prokuror si dhe 3 Këshilltar të Lartë juridik të Gjykatës Kushtetuese dhe 5 avokat .Gjyqtarët dhe Prokurorët ishin nga niveli i Supremes, Apelit dhe Themelores.



Aktivitetet për profesionet e lira

Trajnim i avancuar për paarandalimin e dhunës në Familje-Konventa e Stambollit

Më 22 shtator 2023, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Organizatën Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Rajonal – CLARD dhe IKD, kanë realizuar trajnimin me temë “Trajnim i avancuar për parandalimin e Dhunës në Familje - Konventa e Stambollit”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që avokatët të njoftohen lidhur me Konventën e Stambollit si mjet i rëndësishëm për luftimin e sfidave në rastet e dhunës në familje dhe zbatimin e e saj në praktikë.

Gjatë këtij trajnimi u diskutua për konceptet themelore të Konventës së Stambollit si instrument ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe mbrojtjen nga dhuna në familje. U potencua që zbatimi i saj në praktikë është domosdoshmëri meqë tashmë pjesë e legjislacio-

nit në fuqi pasi është akceptuar edhe nga Kushtetuta e Kosovës.



Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Ky aktivitet është implementuar nga CLARD në partneritet me Institutin e Kosovë për Drejtësi IKD dhe në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë dhe në mbështetje të Ambasadës Amerikane në Prishtinë Departamentit të Shtetit Amerikan Byrosë së Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit INL.


Këtë trajnim e kanë vijuar 8 avokat nga Oda e Avokatëve të Kosovës.



Vijueshmëria në trajnime në PTF e shfaqur përmes grafikoneve




Vijueshmëria në trajnime në PTV e shfaqur përmes grafikoneve




Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve


Numri i pjesëmarrjes dhe trajnimeve të realizuara sipas fushës - Shtator 2023






Numri i pjesëmarrjes në trajnimet e realizuara - Shtator 2023



Pjesëmarrja sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike - Shtator 2023



Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve



Akademia e Drejtësisë

<https://ad.rks-gov.net>

infoad@rks-gov.net

Rr. "Murat Mehmeti" nr. 1-3, Prishtinë

Tel:+383 38 200 18 660